



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT - OPŠTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazna

Nr. -1- 127
Br.

Data 19. 09. 2023
Datum

OBILIQ-OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIC - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.30.08.2023, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë:Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Labinot Mirena (IQO),Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Florije Jashari (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Ajshe Haliti Pllana (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Valon Svirca (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Linda Sadiku Krasniqi (LDK), Bajram Hashani (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK),Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic(SL).

Të pranishmit tjerë: Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, drejtorët komunal, Festina Preniqi, zyrtare për marrëdhënie me publikun, Burim Gërguri, shef i kabinetit të Kryetarit, përf, e KFOR-it dhe përf, e OSBE-së

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cilipasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i dy (2) ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Planit për Ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Obiliqit 2023-2025
- 4.Raporti i Komisionit mbi pronat komunale
5. Shqyrtimi i kërkesës nga DEFZH-ja, për faljen tatimore për vitin 2023
- 6.Shqyrtimi i kërkesës për plotësim ndryshimin e Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve nr.-I-108, të dt.25.11.2016
7. Shqyrtimi i kërkesave
- 8.Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës i cili u miratua me 20 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohen ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara me 20 vota për.

Pika e 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën e DSHMS-së, për shqyrtimin dhe aprovimin e Draft Planit për Riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Obiliqit 2023-2025.

Enver Gashi – Ne jemi që të aprovohet ky Plan pasi që i ka kaluar të gjitha fazat e parapara me ligj.

Sami Ahmeti – Realisht është një dokument shumë i rëndësishëm, që nuk e kontestojmë fare dhe me aq sa kemi lexue është në rregullë në bazë të kësaj që kemi parë. E kisha lutë drejtoreshën si sponsoruesja e këtij Plani, që të na informoj pak për shifrat e të riatdhesuarve, për shifrat e personave që i kemi jashtë sepe mbi bazën e diçkafit është kërkuar ky Plan me u bë, që pak a shumë të na informoj edhe në shkresën paraprake. Përndryshe, si Plan, si i tillë ne jemi dakord dhe e mbështesim.

Kryesuesja – Z.Ahmeti, drejtoresha është në pushim, por në mbledhjen e radhës mund ti sjellë të gjitha shifrat.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 21 vota për morën Vendim për Aprovimin e Planit për Riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Obiliqit 2023-2025.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Ju raportin e Komisionit mbi pronat komunale e keni marrë, atëherë edhe e hapë debatin.

Enver Gashi – Ne edhe në mbledhjen e KPF-së, kemi debatuar për raportin e Komisionit mbi pronat komunale dhe mendoj se raporti është i mirë. Uroj që

çdo 6 muaj të na vjen një raport i tillë sipas praktikave që kanë shkue deri më sot në mënyrë që ne ti shohim zhvillimet qysh po shkojnë.

Sami Ahmeti – E cekëm edhe në mbledhjen e KPF-së, se e mirëpresim secilin raport, mbi të gjitha është edhe obligim i institucioneve, që të na ofrojnë këtë. Bëhet fjalë për një raport me 5 pika, të cilat në asnjë prej raporteve paraprake nuk e kemi parë deri më tani, të cilat pothuajse në shumicën e rasteve përjashtuar një i referohen vitit 2010, që konsiderohet se ka kaluar faza kur është dashtë që ato të fillojnë me aktivitetet e tyre. Për shembull te pika 2, veç vërtetohet se operatori ekonomik nuk i ka plotësuar kushtet dhe nuk është fare duke punuar edhe pse e ka marrë prej vitit 2010. Unë jam shumë i sigurtë se edhe në shumë prona të tjera, është çështja e njejtë, por nuk është ardhë deri te një përfundim i tillë. E thashë e mirëpres secilin raport sepse nuk ka të keqe prej tij, mos të ketë raporte selektive dhe masa selektive sepse duke u nisë nga kjo mundemi te shumë prona, madje edhe te disa shumë specifike me gjetë vërejtje dhe me marrë masa ndaj tyre. Gjithsesi, ne si subjekt politik dhe si anëtarë të Kuvendit Komunal të këtij subjekti, jemi që secili që nuk i plotëson kushtet, ndërron destinacionet e shumë çështje tjera, që të ju anulohet ajo marrëveshje që është bërë. Mirëpo, si i tillë më duket se i kam bërë disa pyetje, le të jetë edhe Komisioni këtu, në mënyrë që të na informoj pse ky raport është i veçantë prej raporteve tjera, pse deri më tani në asnjë prej raporteve paraprake nuk kanë qenë të përfshira këto subjekte të cilat e shfrytëzojnë pronën komunale.

Kryesuesja – Komisioni është këtu dhe drejtori, por nëse ju dakordoheni kishim kërkuar nga Komisioni bashkë me drejtorin që në mbledhjen e radhës të na sjellin një raport me ato kompani të cilat nuk e kanë filluar fare zhvillimin e aktivitetit dhe ju mund të vendosni që me ua marrë atë të drejtë.

Arben Berisha – Sipas raportit të Komisionit, i kemi të detalizuara komplet se çka ka ndodhë me pronat. Këtu, kemi të bëjmë me 3 kategori dhe një është e cila e kanë marrë pronën, kanë kryer investime dhe jemi në rregullë. E kemi kategorinë e dytë, të cilët e kanë marrë pronën, kanë aplikuar për kushte dhe leje ndërtimore, por për shkak të zhvillimeve të planit zhvillimor dhe hartës zonale, ne nuk po mundemi me i pajisë me leje ndërtimore. E kemi edhe kategorinë e tretë të cilët nuk janë lajmëruar asnjëherë, as për kushte, as për asnjë dokument. Në seancën e radhës nëse, ju kërkoni edhe pse këtu komplet i keni të detalizuara, ne ua bëjmë një raport një për një dhe të bashkangjitur komplet.

Sami Ahmeti – Është bërë një traditë që Ekzekutivi sjellë në Kuvend kërkesat në njëfarë mënyre pak si klandestine, këto janë për Kuvendin. Ndërsa, nëse Kuvendi merrë një vendim, normal që Ekzekutivi e ka obligim me mbikqyrë atë kontratë a po shkon, qysh po funksionon dhe a është gjithqka në rregullë. Gjithsesi, që duhet dhe është mirë të na vjen një raport, por edhe të na propozohen prej Ekzekutivit, masat të cilat duhet të ndërmerren sepse ka pasë një kontratë a është zhvillue plani dinamik, a janë ndërrue destinacioet sepse shumë operatorë ekonomik i kanë marrë pronat për diçka tjetër dhe tash po zhvillojnë diçka tjetër dhe shumë gjëra tjera. Ne si Kuvend, përveç që marrim vendim për me ua dhënë, ose me ua marrë pronat, është mirë që ky Kuvend ta themeloj edhe një Komision, që ta bëjë një verifikim sepse e vlerësoj punën e Komisionit kushdo qofshin ata, por gjithsesi edhe Kuvendi Komunal, si organi më i lartë dhe personat obligativ që janë me mbikqyrë këtë proces që vetë e miratojnë, është mirë me marrë pjesë në këto punë. Ne nuk jemi kundër raporteve, po e them prapë mirëpo, ato të jenë korrekte dhe mos të jenë selektive.

Kryesuesja – Ju njoftoj se transmetimi i mbledhjes nuk është duke shkuar live për shkak të problemeve me web faqen nga ana e Ministrisë.

Kryetari – Sa i përket raportit të Komisionit, mendoj se Komisioni e ka sjellë në mënyrë detale edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe mendoj se KPF-ja, e ka të drejtën secilën veç e veç ta trajtoj duke u bazuar në raportin e Komisionit. Ne kemi thënë se Ekzekutivi nuk jepë prona, por Kuvendi dhe është e drejtë e secilit që don me plotësue, apo me ndryshue kontratën paraprakisht duhet ti adresoj kërkesat te Kuvendi me qëllim që ju ti jepni atë të drejtë.

Kryesuesja – E lus, drejtorin që në mbledhjen e radhës të sjellë një raport të veçantë lidhur me pronat që nuk kanë filluar aktivitetet dhe nuk po përgjegjen për bizneset që i kanë marrë.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga DEFZH- së, për faljen tatimore për vitin 2023.

Enver Gashi – Ne si grup parlamentar jemi për që të kaloj kjo kërkesë e DEFZH-së.

Sami Ahmeti – E biseduam edhe në mbledhjen e KPF-së, pas një iniciative që ne e patëm mbajtë një mbledhje të jashtëzakonshme, me mbështetjen e tërësishme te pika e parë që ka qenë falja e tatimit në pronë për vitin 2023. Duhet të informohen mirë qytetarët se falja sipas ligjit do të jetë deri në 100 euro, dhe ata që kanë bërë pagesë falja i rikompensohet për vitin 2024. Ndërsa, ne e mirëpresim do të thotë se Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka marrë vendim dhe ka bërë plotësim ndryshimin e ligjit i cili e rregullon infrastrukturën për me ekzekutue këtë vendim, kështu që qysh e tha parafolësi edhe ne gjithsesi jemi për me mbështetë këtë ndihmesë ndaj qytetarëve dhe ju falenderojmë shumë që kemi ardhë deri këtu.

Xhelal Krasniqi – Ne realisht e kemi pasë një seancë të jashtëzakonshme me dt.02.02.2023 lidhur me këtë temë ku ne si Kuvend Komunal kemi kërkuar që të krijohet rruga ligjore për faljen e këtij tatimi. Për këtë iniciativë kemi parë se ka pasë pakënaqësi dhe ka pasë vota kundër kësaj ideje. E dyta, ne si Kuvend Komunal, mendoj se e kemi obligim me ruajtë paranë publike dhe ne jemi gjithsesi për me ua falë tatimin në pronë sepse është në të mirën e qytetarëve dhe kur është interesi i qytetarëve është mbi interesat e subjekteve politike. Mirëpo, një vendim të cilin e ka nxjerrë Ministria e financave, dhe ka ngritë kuotën, apo koeficientin e ngritjes së tatimit në pronë, unë kisha thënë si Xhelal, si anëtar i këtij Kuvendi, që të shtohet një pasues: "Kërkohet nga Ministria e financave, që të rimbursohen të hyrat e Komunës". Kërkoj nga drejtoresha e financave, që kur e harton buxhetin komunal, le ti planifikon të hyrat në shumën prej 250,000 euro, dhe le të jetë në domenin, apo në përgjegjësiës e Ministrisë së financave, në mënyrë që me atë shumë mos të penalizohet Komuna jonë.

Kryesuesja – Ne në ligj nuk mund të shtojmë apo ndryshojmë diçka. Kryetari dhe ne edhe herën e parë kemi qenë për falje, por nuk kemi pasë bazë ligjore. Mirëpo, tash është krijuar baza ligjore dhe Kryetari menjëherë e ka sjellë kërkesën se sa do ti kushtoj Komunës, sepse janë qytetarë të Komunës, janë tatimpagues. Prapë mjetet kthehen te ata qytetarë dhe prapë do të fillojnë me pagesat tjera ku pastaj, mjetet derdhen në buxhetin e Komunës.

Xhelal Krasniqi – Ne po e shohim përderisa ka mund Ministria përkatëse e linjës me bë një ligj atëherë, le te nxjerrë edhe një nen, si kërkesë e jona është që ta nxjerrë edhe një nënligj nga i cili do të rimbursohet me këto mjete Komuna jonë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 20 vota për morën Vendim për Aproximin e faljes tatimore për të gjithë qytetarët e Komunës së Obiliqit, për vitin 2023.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën e DAP-së, për plotësim ndryshimin e Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve nr.-I-108, të dt.25.11.2016.

Enver Gashi – Ne jemi për që kjo kërkesë të aprovohet.

Sami Ahmeti – Ne jemi dakord që kjo Rregullore të shkoj në debat publik.

Anëtarët e Kuvendit Komunal me 21 vota për morën Vendim për dhënien në debat publik të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve, nr.-I-108, të dt.25.11.2016.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga Muhamet Berisha, përfaqësues i autorizuar i “Bermas Therm” SH.P.K. për ndryshim të destinimit të kontratës.

Enver Gashi – Është fat i mirë që në Komunën tonë kemi këtë operatorë, që i përmbushë komplet kërkesat që i ka pasë dhe i shfrytëzon kapacitetet e mundshme në atë objekt me zhvillue edhe një operim tjetër, apo në destinacion tjetër me qëllim të rritjes së vlerës të objektit dhe pronës, si dhe punësimit të njerëzve të këtij rrethi. Ne si grup parlamentar jemi që kësaj kompanie “Bermas Therm” ti jepet leja dhe të vazhdoj punimet edhe në gastronomi.

Sami Ahmeti – Jo rastësisht, e ceka disa herë gjatë shqyrtimit të raportit paraprak që kishte të bëjë me pronat, është pikërisht kjo çështje që e bën Kuvendin Komunal si mashë vetëm për me shfrytëzue ndaj vendimeve që po merren, mendoj nën tavolinë. Personi në fjalë edhe në raportet e cekura, ai tashmë po e zhvillon këtë aktivitet, ai tashmë ka ndërtime dhe ka vendosë një kat të atij objekti në funksion të sallave të dasmave, apo eventeve të ndryshme. Tash, po kërkon edhe gastronomi në zonën industriale, që mendoj se kjo nuk është në rregull sepse nëse, ai kërkon me hap një restorant, apo një sallë dasmash nuk do të duhej të ishte ai në zonën industriale. E dimë për kend bëhet fjalë, e dimë se si po vepron dhe jorastësisht e thashë se po bëhen vendime masa selektive. Mendoj që Kuvendi Komunal, duhet me pasë kujdes para se të bëjë votime të tilla sepse këto vendime sikurse edhe disa vendime që aktualisht janë duke u zhvillue, e që Prokuroria është duke marrë njerëz në pyetje për shembull për gurëthyesin në Sibofc, do të bëhen subjekt i secilit prej neve, me u hetue nesër në Gjykatë qysh kemi marrë ne vendim me ia ndërrue destinacionin një prone. Ndërsa, ai zotëriu e ka marrë krejtë për një fabrikë të prodhimit të mjeteve termo, në ndërkohë që tash don me bë sallë të dasmave. Mendoj se kjo formë qysh ne po e zhvillojmë do të na çënoj secilin prej neve dhe si rrjedhojë pa marrë parasysh se e di që marrëveshja veç është arritë dhe fakti në shkresa në mes rreshtave kuptohet se dikush prej këtu, e ka shkruar këtë kërkesë. Kërkoj që sipas ligjit të na evidentohen emrat në procesverbal të personave të cilët votojnë kundër këtij vendimi sepse jam i sigurtë që edhe MAPL-ja, do ta kthej prapa çfarëdo vendimi që merret për ndryshimin e destinacionit.

Ajet Berisha – Në raportet e mëhershme kam pasë vërejtje të jashtëzakonshme dhe fillimisht unë dyshoj që raportet janë krejtë korrekte për kompanitë që kanë marrë prona komunale dhe në raport paraqitet fakti qysh është në terren, dyshoj në këtë. Kjo, mund të jetë subjektive, por dyshimi është duke i vlerësuar raportet 6 mujore që kanë ardhë, e shohë që nuk kanë përputhje njëra me tjetrën, për këtë edhe dyshoj. E dyta, edhe më heret e kam thënë se ka kompani të cilat në bazë të planit dinamik dhe shërbimeve, që kanë dashtë me ofrue nga prona e marrë i kanë realizue ato qëllime. Normalisht vetë ekonomia e tregut është e tillë në rast se ti ke mbërri me realizue një plan sidomos kur është nevoja, apo kërkesa për 99 vite mënyra e zhvillimit të bizneseve, ne si Kuvend Komunal kjo është kërkesa e parë. Mirëpo, në vazhdimësi do të kemi kërkesa të tilla, që është insistim edhe i imi e duhet të jetë edhe i Komunës dhe i këtij Kuvendi, që në rast se pronat janë dhënë për 99 vite, pavarësisht për planet dinamike që kanë ofruar ata, që ne duhet të kërkojmë gjithsesi që ata ti realizojnë. Në momentin që ata i realizojnë planet dinamike të kohës

për me u zhvillue, do të kenë kërkesa mëtutje që biznesi i tyre të zhvillohet. Ju njoftoj se të drejtë vote në këtë lëndë nuk kam sepse është konflikt interesi dhe personi që ka bërë kërkesë është pikërisht daja im, që është një djalë shumë punëtor, shumë i mirë dhe është biznesmen shumë i shquar. Ai biznesin e vet e zhvillon në Gjermani. Këtu, ka investu që është investim shtesë dhe këtij iu ka dhënë prona për 99 vite, dhe qëllimin për të cilin e ka marrë ai e ka realizue planin. Meqë, e ka realizue është problem tjetër në rast se ai pa ndonjë kërkesë ka bërë ndërtim, do të thotë këtë po e abstrahoj është problem i Komunës me ndërtuesin. Përndryshe, në rast se ai një pronë prej 1 hektarëve, e ka marrë dhe e ka realizue planin, është duke funksionue dhe punue, në atë hapësirë ka mundësi me u zhvillue ende, që interesin ia shehë Komuna, ia shehë familja e vet dhe tjerët, unë jam që në mënyrë ligjore këtyre, gjithsesi asnjë pengesë mos të iu bëhet. Askush mos të penalizohet, as Kryetari, as drejtori dhe as Kuvendi. Jo, vetëm për këtë edhe pse ky është daja im, unë flas për secilin operatorë i cili e ka realizue planin për të cilin ka konkurue dhe sot në kuadër të asaj hapësire ka fuqi me rritë me u gjetë mënyra ligjore që atyre, me iu mundësu me u zhvillue, që mos me mbetë peng i një konkurimi. E marrum me mend para 90 viteve, me çfarë mjete dhe me çfarë biznesi janë zhvillue dhe pas 90 viteve çfarë ndryshimi është sidomos, në këtë kohë ku dinamika e zhvillimit është shumë e madhe. Këto biznese kanë me pasë nevojë në rast se janë ata që punojnë, ecin, kanë me pasë nevojë çdo 5 vite, çdo 10 vite me rishqyrtue jo me zvoglue, por për me rritë biznesin sepse dinamika e zhvillimit është shumë e madhe. Unë normalisht nuk kam të drejtë, por jam përkrahës në parim për të gjitha ato biznese, që kërkojnë që në kuadër të asaj që e kanë marrë me zhvillue, e me rritë. Tani, çka parashihet në atë zonë industriale, në rast se kjo është pengesë mund me u shqyrtue, por nuk ma merrë mendja sepse ai ka një hapësirë ku mund ta bëjë edhe atë, edhe atë e ndoshta në të ardhmen edhe

diçka tjetër. Mua, më vjen keq që për këtë rast nuk kam të drejtë me votue sepse është konflikt interesi përndryshe, për cilindo që bën një kërkesë të tillë dhe është në kuadër të rregullave, unë jam për.

Kryesuesja – Unë sa po e kuptoj kërkesën këtu, nuk është për me ndërpre prodhimin e materialeve për nxemje qëndrore nëntokësore, por ai po kërkon punë shtesë

Enver Gashi – Në fillim unë e thashë se është një fat që një biznesmen i tillë është në Komunën tonë dhe i ka përmbushë të gjitha kriteret, por tash ai don me rritë edhe vlerën e atij vendi me një objekt shtesë atëherë, pse ne mos me votue. Ne kemi problem me tjerët, që nuk e kanë nisë, ose e kanë nisë dhe e kanë lënë në gjysmë. Ju shumë mirë e cekët se ka fillue edhe me eksportue dhe tash ne me thënë jo nuk bën, pse nuk bën kur ai pas 20 vjete, mund të kërkoj krejtë diçka tjetër dhe ky Kuvend ka me u marrë me atë temë me ua mundësue njerëzve. Nuk ka ndryshim të destinacionit, ai i ka plotësue të gjitha edhe më shumë se që duhet dhe tash është vetëm plotësim, rritje e biznesit.

Sami Ahmeti – Dua ta japë edhe një arsyetim shtesë. Edhe në fjalimin tim paraparak e thashë se tashmë ai veç e ka zhvillue dhe ka krijue këtë biznes, të cilin pasi që e ka krijue po kërkon leje. Unë jam plotësisht dakord me ato nëse, i ka plotësue ashtu ka pozicion, por jo pasi që veç është duke e zhvillue atë aktivitet. Ai konsiderohet se edhe në kërkesën e vet ka dhënë deklaram të rrejshëm sepse ka thënë se i kam plotësue të gjitha kushtet, në ndërkohë që në raportin e muajit të kaluar të Komisionit, thuhet se ai i ka tejkalue obligimet që i ka pasë dhe ka filluar një biznes, për të cilin nuk ka pasë leje. Gjithashtu, edhe në përgjegjen e drejtorit thuhet se ai tashmë, ka kalue limitet për të cilat ka qenë i paraparë me bë, ky është qëllimi. Tash, a duhet dikush së pari me fillue e me ndërtue pastaj, me sjellë në Kuvend sepse Kuvendi në njëfarë mënyre po përdoret si zorrë qorre, kur po ka nevojë po vjen në Kuvend dhe me u fshehë pas Kuvendit. Realisht, ky është problemi dhe nuk është problemi a i plotëson kushtet, apo nuk i plotëson. Unë i besoj Komisionit, që është një Komision zyrtar i cili jo vetëm se e ka obligim, por merren edhe masa ndaj tij nëse, deklaroi rrejshëm. Ky është qëllimi për çka ne do të votojmë kundër sepse po themelohet një rrethanë e po na qesin para aktit të kryer, ku e kemi inspeksionin, çfarë masa janë marrë nëse, ai veç tashmë i ka tejkalue ato obligimet që i ka pasë.

Kryesuesja – Kërkon që z.Ajet Berisha para votimit ta lëshon sallën e Kuvendit Komunal.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 14 vota për dhe 4 vota kundër (Sami Ahmeti, Valon Svirca, Ajshe Haliti Pllana dhe Albana Shillova Shalaku) morën Vendim për aprovimin e kërkesës nga Muhamet Berisha, përfaqësues i autorizuar i “Bermas Therm” SH.P.K. për ndryshim plotësimin e destinimit në mënyrë që përveç fabrikës për prodhimin e materialeve termoizoluese për nxemjet qendrore nëntokësore, ti mundësohet edhe operimi i biznesit të gastronomisë.

Pika 8 e rendit të ditëa

Kryesuesja – Në mbledhjen e KPF-së, z.Gashi, ka kërkuar nga Drejtoria e Arsimit të na njoftoj më detajisht lidhur me tekstet shkollore për fëmijët dhe gjithçka që ka të bëjë me fillimin e vitit të ri shkollor. **Sahit Zeqiri** – Ne qysh në fillim të muajit prill kemi bërë parapërgatitje për të gjitha nivelet e shkollës, duke filluar prej klasës së 1-5. Pastaj, na është krijuar një atmosferë e pakëndshme me vendim të Ministrisë së Arsimit, në nivel të Republikës së Kosovës, se do të kemi vështirësi për furnizim të librave për nxënësit. Vështirësitë kanë me qenë të ndryshme edhe pse në bazë të planifikimit të Ministrisë së Arsimit, procesi mësimor do të hapet me 1 shtator. Mirëpo, këto vështirësi se si do të mbulohe mi ne dhe a do të fillojmë me kohë ndoshta, është vështirë të japim ndonjë koment të vërtetë se si do të veprojmë në këtë situatë. Sipas raportit në klasën e parë i kemi 409 fëmijë, në klasën e dytë i kemi 393, në klasën e 3 i kemi 389, në klasën e 4, i kemi 359 dhe në klasën e 5, i kemi 328, gjithsejtë janë 1,628 nxënës, të cilët është dashur që para se të filloj viti shkollor të jenë të kompletuar me tekste. Vlera totale është rreth 20,000 ekzemplarë që mesatarisht për numër të nxënësve i bjen nga 12 libra, ti ketë çdo nxënës pa fletoret e punës në këtë rast. Ndërsa, te klasët e 6,7,8 dhe 9 jemi përpjekur me drejtorët e të gjitha shkollave, që tekstet paraprake të vitit të kaluar të ruhen dhe mendoj se këtu, do ta kemi një mbulesë afërsisht mbi 90 % dhe me këto klasë mund ta fillojmë procesin mësimor pa asnjë pengesë. Më e keqja është se në Komunën tonë ekziston vetëm një librari dhe nuk di libraritë a kanë bërë marrëveshje me Ministrinë e Arsimit, për ti destinuar tekstet në ato librari. Te prindët, do të jetë një vështirësi shumë e madhe se si do të aplikojnë megjithatë, si DKA me të gjithë drejtorët, mësimdhënësit dhe prindërit do të përpiqemi që ky rast mos të jetë pengesë për moszhvillimin e procesit mësimor.

Enver Gashi – Unë jam edhe inicues i kësaj kërkesë që drejtori të na japë sqarime për Komunën tonë, që janë të mirëseardhura drejtor, të faleminderit. Mirëpo, ta kisha bërë një pyetje në fillim, kjo libraria jonë a i merrë prej krejtë Shtëpive botuese tekstet, apo ka kontratë vetëm me një Shtëpi botuese sepse sipas informatave që i kam nuk është planprogrami i të gjitha teksteve nëpër Shtëpitë botuese në Kosovë i njejtë. Ne në Kosovë, i kemi dikund 224,000 nxënës prej klasës 1-9, dhe deri më tash ka qenë një ligj që tekstet iu kanë dhënë falas, iu kanë dhënë me kohë, iu kanë dhënë prej një Shtëpie botuese dhe po na delë se këta me bë dhe kanë bërë ndryshim epokal, por gjithsesi në dëm të nxënësit, në dëm të prindërve dhe të buxhetit të shtetit. Po e marrim dikund u tha 11 milionë kushtojnë krejtë këto mjete, hajde kush e din mirë matematikën me shumicë me i marrë ato sa milionë kursejmë. Unë e kam pa në media delë përfaqësuesi i Shtëpisë botuese “Dugagjini “ dhe thotë se në këtë vit kemi aplikue me 4 %, më pak se në vitin e kaluar dhe tash bleni librat i rimbursojmë, qysh ka me i rimbursu, në Obiliq ka mi ble sigurisht më shtrenjtë, dikund në viset tjera rurale edhe më shtrenjtë. Me ia dhënë Prishtinës, 70 euro, Obiliqit duhet me ia dhënë 80 euro, dhe kush është ai institucion që mundet me i kontrollue 224,000 aplikacione, por një fjalë popullore thotë: “ujku don mjegull”.

Sahit Zeqiri – Unë ia kisha kalue fjalën z.Rexhep Zekës, pasi që është edhe kordinator nga vitet e kaluara, i cili mund të na njofton në detaje.

Rexhep Zeka – Unë jam kordinator për furnizim me tekste shkollore në Komunën e Obiliqit. Shumë mirë e tha drejtori se Ministria e Arsimit, e ka bërë katalogun dhe me Shtëpitë botuese për furnizimin e titujve me libra prej klasës 1-5. Pastaj, arkivet profesionale brenda shkollës përmes drejtorit kanë mbërri te ne që secila shkollë me cilat tekste botuese kanë me u furnizue. Drejtoria e Arsimit, e ka publikue në faqen zyrtare të Komunës, në mënyrë që të gjithë qytetarët e Komunës ta shohin. Është krijuar një tollovi e madhe këtë vit për furnizim me tekste shkollore, për vetë faktin se tekstet kanë ardhë në një pikë

grumbulluese dhe përgjegjësinë e ka marrë Drejtoria e Arsimit me i shpërnda nëpër shkolla. Tash, ne po e shohim edhe shqetësimin e prindërve edhe përmes mediave, sepse ka shumë prindë të cilët nuk janë të regjistruar në platformën ekosova, dhe e kanë sfidë me i sigurue mjetet sepse realisht është shumë vonë. Edhe unë në cilësinë e prindit kam aplikuar dhe thotë të njoftojmë me procedurat e mëtutjeshme, por kur mbërrijnë ata me i krye krejtë prindët me këto mjete. Katallogu i parë që e kemi publikue nuk i përfshin të gjitha tekstet prej klasës së 1-5, katallogun e dytë e kemi me dorëzue sot, do të thotë data 1 shtator ende nuk e përfshin edhe katallogun e dytë komplet tekstet shkollore prej klasës 1-5. Më heret ka qenë një përgjegjësi më e madhe e Ministrisë së Arsimit, e Drejtorisë së Arsimit, për me mbërritë tekstet në duar të nxënësve dhe prindërve, por është një vendim i kësaj Ministrie krejtë në fund sepse sikur të kishte qenë me këto detaje që nga prilli edhe vetë Ministria kishte me pasë kohë, edhe prindët me iu përgatitë kësaj pune. Prandaj, në këtë situatë mbetet që Ministria e Arsimit, me sqarue këtë çështje, e jo ne.

Sami Ahmeti – Derisa është një vendim për të gjithë Republikën, i mirë apo i keq mbetet pasi që të realizohet me u vërtetue se qysh ka rezultue. Unë nuk është shumë që kisha bisedue për këtë çështje sepse me rëndësi është me sa kam informata libraria “Xha Limani” duke ardhë këtu u ndala për me pasë të sigurtë që nuk kemi nevojë me bë reklamë, por unë veç bisedova me të, tha se i kemi të gjithë titujt, kemi mjaftueshëm në bazë të numrit. Këtë listën që e tha drejtori paraprakisht se 409 nxënës të cilët kanë kërkuar prej Shtëpisë botuese “Dugagjini” dhe Pegi po shkruan, e kam prej Ministrisë që ka shkue shumë më heret prej DKA-së, se me cilat planprograme punohet. Mbi bazën e kësaj janë evidentue sa ka nevojë prej librarisë “Dugagjinit” sa prej Shtëpive tjera botuese dhe sipas informatave ka mjaftueshëm tituj. Tani, a do të ketë tollovi për atë është problem i tij, ai e menaxhon punën se qysh i shpërndan ndërsa, për prindë e kuprojmë se do të jetë pak më vështirë, por në fund të fundit e bëjnë për fëmijët e vetë. Sa i përket kësaj logjikës që unë e quaj të biznesit, pajtohem plotësisht me z.Enver, që tha me shumicë dhe pakicë në logjikën e biznesit pikërisht ajo funksionon, do të thotë kur merret diçka me shumicë merret më lirë ndërsa, me pakicë është pak më shtrenjtë. Në ndërkohë me atë që unë kam parë në Ministrinë e Arsimit, që kam pasë mundësi dhe i kam pa ato dokumente është përdorë logjika e plaçkitjes së shtetit, do të thotë dy e trefish më shumë

çmimet për një abetare për shembull dhe për shumë libra tjera. Mirëpo, nuk besoj se është Kuvendi Komunal, me bisedue për këto çështje, por kisha dashtë me pyet drejtorin e nëse, nuk mundet me u përgjegjë le të përgjegjet kordinatori qysh janë parapërgatitjet tjera, sepse është problem që në secilin vit për shembull në shkollën në Milloshevë, humben ditë të tëra për shkak të nxemjes ndërsa, në shkollat tjera me probleme të njejta a janë sanue këto probleme që në këto mos të ketë humbje. Ndërsa, sa i përket vendimeve që janë në mbarë Republikën, besoj se nuk mundemi me ndryeshue, e me folë mundemi sa të doni.

Ajet Berisha – Nga përvoja e jetës time, ose me atë fukarallëk që kemi qenë librat i kemi ble vetë. Mirëpo, problemi nuk është këtu, por problemi është në vendimet ad-hoc në cilindo nivel që merren sa dëme shkaktojnë në terren. Edhe në rastin konkret mendoj se pavarësisht sa ka mund me i kushtue më shtrenjtë Qeverisë, ky vendim është marrë në momentin e fundit, pa ndonjë studim dhe pa përgatitje të terrenit, që në këtë vit librat nuk do ti siguroj Qeveria, do të thotë ka bë dëme. Tani, a kanë nevojë të gjithë nxënësit e Kosovës, që librat me ua ble Qeveria, unë pajtohem që jo sepse shumë familje i kanë mundësitë përtej kësaj që me i sigurue librat. Mirëpo, a ka nxënës dhe familje që vërtetë kanë nevojë që dikush me ua sigurue ato libra, edhe ky është kogja numër i madh. Për atë vendimet nuk duhet të merren ad-hoc dhe aty për aty pavarësisht nëse, Komunës dhe shtetit i kushton pak më shumë. Mendoj se do të kishte qenë shumë me rëndësi që kjo Qeveri me thënë rasteve sociale, rasteve që janë në vështirësi ekonomike librat do të ia siguroj Qeveria, ndërsa pjesën tjetër le ti sigurojnë prindët vetë sepse kanë mundësi vetë dhe askush nuk e len për libra fëmijun mos me shkue në shkollë. Mirëpo, ka edhe nxënës të tillë që do të shkoj gjysëmvetori sepse nuk kanë mundësi me aplikue, nuk dinë që do të thotë se ka probleme të ndryshme, nuk ka edhe nga ku me aplikue se nuk ka edhe me ngrënë bukë, e lëre më me

sigurue një telefon të mençëm. Po ashtu, ka që ende nuk është i regjistruar hiç, që duhet me mendue deri atje sepse shteti është me i mbrojtë sidomos këto kategori, jo të atyre që kanë kapacitete me i sigurue vetë librat. Vendimet ad-hoc, të pastudjuara i kushtojnë popullit, e sheshherë ne dimë me thënë se ne jemi me popullin dhe kur na cënohet buxheti ne e ruajmë buxhetin. Kjo, nuk përputhet dhe nuk duhet me thënë as ne jemi me popullin sepse populli është një masë amorfe, nuk është qind për qindëshi qysh mendon ti dhe nuk i ka nevojat qysh mendon ti sepse nuk e ke studjue. Edhe çështja e buxhetit, buxheti është i këtij populli, do të thotë nuk është që këto veprojnë ndaras, por me lojë fjalësh ne herë gjuajmë te populli e herë e ruajmë buxhetin dhe problemin e shkaktojmë në terren. E njejtja ishte edhe për vendimin që e votuam për falje të tatimit, pse duhet me u gëzue ne kur e falim tatimin, nuk duhet me falë sepse shteti ndërtohet mbi bazën e taksave e tatimeve. Në vitin 2016, ose 2017 më kujtohet në Zvicër shteti zviceran ka thënë nga 2,200 frangë secilit qytetar që është mbi 18 vjet, mund të ia ofroj dhe ata dolën në referendum 72 % kundër, do të thotë duhet logjika e ndërtimit të shtetit. Pra, nuk bëhet ti iku taksës, te uli taksën me çdo kusht, por duhet me një logjikë të veprimit se e ke terrenin kështu, duhet me njoftë terrenin, me u konsultue me ekspertë dhe me marrë vendim. Tash, qohet në një mëngjez Drejtorja apo Ministria cilado po e ndërroj këtë vendim, jo ore ti po e prekë popullatën, nuk guxon kështu, jo unë jam i fortë e ju nuk keni çka me bë.

Është e vërtetë se nuk kemi çka me bë, as me vendimin e Komunës, as të Qeverisë, por secili që vepron në këtë mënyrë e ka gabim sepse po preket më i dobëti, që nuk është masë e vogël e njerëzve. E dyta, edhe një problem tjetër që e pashë në aplikim te nxënësit e klasës së 6, në rast se nxënësi i klasës së 6 ka hy një vit më heret në shkollë-ai nuk mundet me aplikue për masën e mjeteve sa ishte 30 euro dhe ai tash, po aplikon për masën 50, e po i merrë 80 euro, do të thotë është një problem serioz se ai pa të drejtë i merrë 50 euro më tepër. Ky, është një problem tjetër që duhet me shqyrtue dhe me ngritë menjëherë këtë problem sepse këtu, tash është një masë e mjeteve që ka me u dëmtue buxheti në mënyrë të padrejtë.

Xhelal Krasniqi – Sipas Ligjit për Arsimin parauniversitar, neni 26 paragrafi 4 thotë se tekstet shkollore të miratuara nga Këshilli drejtues në nivelin 1 dhe në nivelin 2 në bazë të paragrafit 2 të këtij neni, ofrohen librat falas. I nderuari drejtor, në takimet që i keni pasë me Ministrinë e Arsimit, a është shfuqizue ky ligj i cili realisht e garanton, apo është nxjerrë vendim mbi ligjin. E dyta, a janë furnizue shkollat me ditar dhe libra amë dhe çfarë do të ndodhë, ose si duhet të obligohen kur dihet se fletoret pune realisht nuk mund të përdoren për gjeneratat e ardhshme sepse ato plotësohen, që në njëfarë mënyre nuk mund të përdoren më.

Valbonë Beka - Unë e kam një pyetje për Drejtorinë e Arsimit, qe sa vite po flitet digjitalizimi, digjitalizimi dhe as fletë të bardha nganjëherë nuk kemi nëpër shkolla. Deshta të pyes kur do të kryhet ai digjitalizim, kur do të bëhet të paktën një projektor ose një smart board nëpër klasa.

Sahit Zeqiri – Së pari i përgjegjem z.Ahmeti, se Drejtorja e Arsimit asnjëherë nuk ka zhvilluar dhe nuk do të zhvillon politikë sepse politikën me nxënësia dhe fëmijë, sa më largë duart prej tyre dhe kurrë unë për vete këtë praktikë nuk do ta zbatoj asnjëherë. Z.Ajet, diskutoi dhe shumë bukur e tha se nuk jemi ne këtu, që mund të marrin vendim dhe me ndalue nivelin qëndror qysh punojnë dhe çka punojnë. Tash, a është mirë, nuk është mirë sepse janë krijuar rrethanat në momentin e fundit kur ne duhet ta zhvillojmë procesin mësimor. E dyta, ne jemi të përgatitur njëqind për qind për zhvillimin e procesit mësimor me 1 shtator, edhe në aspektin teknik organizativ me plotësimin e kuadrit njëqin për qind, por duhet të jemi real se e kemi pasë një vonesë për renovimin e shkollës, që duhet të përfundojnë punët deri të premtën. Ne kemi projekte të shumta, që unë do ta bëjë një raport kur jeni ju të gatshëm me kërkue raportin për gjithë vitin kalendarik edhe me projekte dhe të gjitha punët që i përkasin Arsimit. Tani, i përgjegjem z.Xhelal, se ne nuk kemi ndonjë vendim që na është njoftue nga Ministria e Arsimit, se është shfuqizue ai vendimi që ju e thatë dhe nuk jemi kompetentë për këtë, që ta bëjmë një vlerësim për këtë çështje. Realisht me marrë dhe me ligj është dashur ai vendim të shfuqizohet për me u marrë ky vendimi tjetër për të cilin ne jemi duke debatue në këtë rast. Znj.Valbonë, bën pyetje provokative shpeshherë, por këto duhet me i rue për veti secili sepse unë mendoj se kemi fillue dhe jemi duke punue në aspektin më të mirë

të ngritjes së cilësisë në të gjitha fushat e Arsimit. Ne kemi projekte të shumta prej vitit 2023 deri në vitin 2026, që e kemi një projekt total 3 milion e 4,70.000 euro. Sa i përket digjitalizimit, në muajin e parë kur kam ardhë e kam në projekt vjetor që do të fillon në vitin e ardhshëm dhe sigurisht në vitin 2025 mendoj se kemi me përfundue me një milion e 270,000 euro. Ndërsa, për letra, shkumësa e tjera, kemi pasë pengesa sepse kompanitë janë vonue, por mendoj se kemi gjëra të mjaftueshme. Arsimi është fushë shumë dimensionale që duhet të bëjmë investime të gjithë dhe asnjëherë nuk mbaron.

Kryesuesja – Për një përgjegje më detale rreth nxemjes që znj.Valbonë, ka bërë pyetjen në KPF, fjalën e ka drejtori për infrastrukturë.

Fatmir Bërbatovci – Përgjegjet se projekti i kogjenerimit i ka 4 faza dhe pa u punue në 4 faza nuk është i shfrytëzueshëm për qytetarët. Faza e parë është ndërtimi i objektit të nënstacionit për pranimin e energjisë termike, që është e kryer, objekti në Obiliq të Vjetër. Faza e dytë është shtrirja e rrjetit të gypave të kogjenerimit, është në proces dhe kjo kontratë zgjatë deri në vitin 2025. Faza e tretë është lidhja e objekteve publike dhe private me rrjet të kogjenereimit dhe instalimi i nënstacioneve me këmbyes nëpër objekte dhe kjo fazë ende nuk ka filluar. Faza e 4 është pranimi i energjisë termike prej Kosovës B, deri te objekti i nënstacionit. Pra, pa u përfundue 4 fazat e projektit nuk mund të ketë ngrohje qëndrore nëpër objekte qofshin ato publike, ose private në Komunën e Obiliqit.

Valbonë Beka – Drejtori tha znj.Valbonë bën pyetje provokative dhe unë asnjëherë nuk jam këtu, për me bë pyetje provokative, por nëse kërkoj diçka kërkoj në të mirë të komunitetit pa u përfshirë në politikë, pa kurgjë.

Rexhep Zeka – Unë i drejtohem znj.Valbonë, le të na tregon se cili mësimdhënës në shkollën profesionale nuk posedon llap top. Ne i kemi 10 klasë në të cilat i kemi projektorët statik, fjala është për digjitalizim, por kemi edhe projektorët tjerë, të cilët janë lëvizës që secili mësimdhënës që don me marrë me përdorë në orë mësimore, e ka të drejtën. Në gjimnaz të gjitha klasët posedojnë projektorë statik, kanë llap top, kemi smart board, kështu që në shkollat e mesme të larta mendoj se është punue dhe është investue në ngritjen e cilësisë që nuk do të thotë se do të mbetet me kaq, por jo në atë gjendje me thënë se në shkolla nuk kemi letër sepse letër ka të mjaftueshme dhe nëse, don tash shkojmë bashkarisht dhe e vizitojmë.

Valbonë Beka – Po, është e vërtetë se shkolla jonë është e pajisur mjaft mirë dhe nuk mund të them se është keq, mirëpo unë nuk e pata fjalën vetëm për shkollën tonë, por në nivel të Komunës

Shaip Paloja – Unë po e shohë një postim të anëtarëve të LVV-së, se gjëja është meritë e tyre falja e 100 euro, për tatimin në pronë dhe besoni kjo është tmerr me çka merren këta njerëz, 4 anëtarë dhe ia kthejnë vetvetes meritën për këtë punë. Kjo Qeveri e ka shkelë ligjin fillimisht për faljen e pronave dhe me presionin e Komunave, e ka nxjerrë ligjin e ri. Kjo, Qeveri po e shkelë edhe ligjin tash për dhënien e librave falas dhe pas 6 muajve, ka me nxjerrë një ligj edhe me përmirësue këtë ligj. Kjo është Qeveri e skandaleve, e shkeljeve ligjore dhe kushtetuese.

Mbledhja përfundoi në ora 12:17'

Bashk.prof. për punë të KK


Azize Zeneli



Kryesuesja e Kuvendit Komunal


Vlora Mjekiqi Kabashi